

KONTRATË PËR DHURIMIN E KUOTAVE

Sot më datë 06 / 02 / 2020 në Tiranë, midis palëve të mëposhtme:

Nga njëra anë:

1. **Z. Dritan Shakohoxha**, shtetas shqiptar, lindur në Vlorë më 15.07.1969, identifikuar me letërnjoftimin me nr. personal G90715175L nr. 027690948, këtu e në vijim referuar si **"Dhuruesi"**;

në praninë e

Znj. Miranda Shakohoxha, shtetase shqiptare, lindur në Cërrik, Elbasan, më 28.05.1970, identifikuar me numër pasaporte BF4146603 dhe numër personal H05528153N (bashkëshorte e Dhuruesit)

Nga ana tjetër:

2. **Z. Nertila Kole**, shtetas shqiptar, lindur më 13.03.1977, në Fier, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal H75313075D dhe nr. 028513114, këtu e në vijim referohet si këtu e në vijim referohet si **"Përfituesi"**,

Lidhet kjo Kontratë Dhurimi me përmbajtje si më poshtë vijon:

NDËRSA Dhuruesi është pronar i një kuote në shoqërinë "ALBAWINGS" SHPK, me numër NUIS L51418010M ("**Shoqëria**"), e cila përfaqëson 41% (dyzet e një përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;

NDËRSA Dhuruesi dëshiron t'i dhurojë Përfituesit një pjesë të kuotës e cila përfaqëson 31% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë dhe të mbetet pronar i pjesës së mbetur të kuotës e cila përfaqëson 10% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë dhe Përfituesi e pranon dhurimin,

ATËHERË: Lidhet kjo Kontratë Dhurimi midis palëve me përmbajtje si më poshtë vijon:

1. OBJEKTI I KONTRATËS

- 1.1 Objekt i kësaj kontrate është dhurimi dhe transferimi i një pjesë të kuotës në pronësi të Dhuruesit në Shoqërinë "ALBAWINGS" SHPK, e cila përfaqëson 31% (tridhjetë e një përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë ("**Kuota e Dhuruar**"). Pjesa e mbetur e cila përfaqëson 10% të kuotës në pronësi të Dhuruesit në kapitalin e Shoqërisë, mbetet në pronësinë e tij, dhe për pasojë kuota

ndahet në dy, ku një kuotë mbetet në pronësi të Dhuruesi dhe përfaqëson 10% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, dhe tjetra kalon në pronësi të Përfituesit dhe përfaqëson 31% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

- 1.2 Pronësia e Kuotës së Dhuruar i kalon Përfituesit në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate, dhe Kuota e Dhuruar do të përfitohen së bashku me të drejtat dhe përfitimet e lidhura me të.

2. PRONËSIA E KUOTËS SË DHURUAR

- 2.1 Kuota e Dhuruar përfaqëson 31% (tridhjetë e një përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- 2.2 Kuota e Dhuruar transferohet dhe kalon në pronësi të Përfituesit në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate të shënuar në faqen e parë të saj.

3. SHPËRBLIMI

- 3.1 Dhurimi i Kuotës së Dhuruar sipas kësaj Kontrate në favor të Përfituesit do të kryhet pa shpërblim.

4. REGJISTRIMI I TRANSFERIMIT DHE PJESËMARRJA NË KAPITAL

- 4.1 Pronësia mbi Kuotën e Dhuruar i kalon Përfituesit në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate të shënuar në faqen e parë të saj dhe Palët duhet të regjistrojnë këtë Kontratë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit menjëherë pas njohjes së Kontratës nga asambleja e përgjithshme të ortakëve të Shoqërisë.

5. DEKLARIMET E GARANCITË E DHURUESIT

- 5.1. Dhuruesi deklaron dhe garanton ndaj Përfituesit dhe në favor të tij, se secila nga garancitë dhe deklaratimet ("Garancitë e Dhuruesit") në vijim janë të vërteta dhe të sakta në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

- (a) Dhuruesi ka të gjithë të drejtat dhe zotësinë ligjore për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate. Miratimi i bashkëshortes së tij është i dhënë nëpërmjet nënshkrimit prej saj të Kontratës;

- (b) Pronësia e Kuotës së Dhuruar:

- i. Dhuruesi është pronari i vetëm ligjor i Kuotës së Dhuruar;
- ii. Kuota e Dhuruar është nënshkruar dhe emetuar në mënyrën e duhur dhe është paguar plotësisht;
- iii. Kuota e Dhuruar dhe të gjitha të drejtat e lidhura me to janë të lira nga cdo lloj pengu apo barre të çfarëdo natyre qoftë.

6. DEKLARIMET DHE GARANCITË E PËRFITUESIT

- 6.1. Përfituesi, paraqet dhe garanton ndaj Dhuruesit dhe në favor të tij, se secila nga garancitë dhe deklaratimet në vijim janë të vërteta dhe të sakta në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

- (a) Përfituesi ka të gjitha të drejtat dhe zotësinë ligjore për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.

7. KOSTOT

- 7.1 Secila Palë duhet të mbajë përsipër kostot e saj lidhur me negociatën, mbylljen dhe nënshkrimin e dokumentave të detyrueshme ligjërisht ose sipas kësaj Kontrate.

7.2 Cdo tarifë, taksë ose tatim që duhet paguar nëse ka të tillë si rezultat i nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe i transferimit të Kuotës së Dhuruar, është në ngarkim të Dhuruesit.

8. **LIGJI I ZBATUESHEM**

8.1 Kjo Kontratë dhe marrëdhëniet midis Palëve do të rregullohen nga legjislacioni shqiptar, dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare.

9. **JURIDIKSIONI**

9.1 Cdo mosmarrveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë përsa i përket zbatueshmërisë ose vlefshmërisë do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

10. **TË NDRYSHME DHE SHITESA**

10.1 Asnjë ndryshim, shtesë, ose tjetërsim i kësaj Kontrate nuk do të jetë e vlefshme nëse nuk është me shkrim në një dokument të vetëm të nënshkruar nga ose për llogari të Palëve.


10.2 Në rast se në çdo kohë ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, atëherë kjo dispozitë do të konsiderohet e pavarur nga kjo Kontratë dhe nëse është e mundur do të zëvendësohet nga një dispozitë e vlefshme, e cila do të shprehë, sa më afër të jetë e mundur, qëllimin e Palëve sipas kësaj Kontrate dhe aty ku është e mundur nuk do ndikojë ose dëmtojë vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e ndonjë dispozite tjetër të Kontratës ose të Kontratës në tërësi e cila do të interpretohet dhe do të zbatohet në mënyrë të pavarur.

11. **GJUHA, KOPJET E KONTRATËS DHE HYRJA NË FUQI**

11.1 Kjo Kontratë hartohet në tre kopje në gjuhën shqipe, një për secilën palë dhe një për Shoqërinë ku secila prej tyre do të konsiderohet origjinale, por të gjitha bashkë do të përbëjnë një dhe të njëjtën Kontratë.


Dhuruesi

Z. Dritan Shakohoxha




Përfituesi

Znj. Nertila Kole



Në praninë dhe me miratimin e:

Znj. Miranda Shakohoxha



KONTRATË PËR DHURIMIN E KUOTAVE

Sot më datë 06/02/2020 në Tiranë, midis palëve të mëposhtme:

Nga njëra anë:

1. **“Travel Hub Solutions” SHPK**- shoqëri e së drejtës shqiptare, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më 30/04/2014, me numër NIPT L41630002R dhe seli në adresën: Vore, Rruga Rinas-Tirane, Tirana Business Park, Ndertesa nr 7, Kati 0, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga administratori i Shoqërisë, Znj. **Nertila Kole**, këtu e në vijim referuar si **“Dhuresi”**;

në praninë e:

Z. Gentjan Kole, shtetas shqiptar, lindur më 27.08.1973, në Kuçovë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal H30827046P dhe nr. 028497795 (bashkëshorti i ortakut të vetëm dhe administratorit të Dhuresit)

Nga ana tjetër:

2. **Znj. Nertila Kole**, shtetas shqiptare, lindur më 13.03.1977, në Fier, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal H75313075D dhe nr. 028513114, këtu e në vijim referuar si **“Përfituesi”**,

Lidhet kjo Kontratë Dhurimi me përmbajtje si më poshtë vijon:

NDËRSA Dhuresi është pronar i një kuote në shoqërinë **ALBAWINGS” SHPK**, me numër NUIS L51418010M (**“Shoqëria”**), e cila përfaqëson 49% (dyzet e nëntë përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë;

NDËRSA Dhuresi dëshiron t'i dhurojë Përfituesit kuotën që zotëron e cila përfaqëson 49% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë dhe Përfituesi e pranon dhurimin,

ATËHERË: Lidhet kjo Kontratë Dhurimi midis palëve me përmbajtje si më poshtë vijon:



1. OBJEKTI I KONTRATËS

- 1.1 Objekt i kësaj kontrate është dhurimi dhe transferimi i kuotës në pronësi të Dhuruesit në Shoqërinë "ALBAWINGS" SHPK, e cila përfaqëson 49% (dyzet e nëntë përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë ("Kuota e Dhuruar").
- 1.2 Pronësia e Kuotës së Dhuruar i kalon Përfituesit në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate, dhe Kuota e Dhuruar do të përfitohen së bashku me të drejtat dhe përfitimet e lidhura me të.

2. PRONËSIA E KUOTËS SË DHURUAR

- 2.1 Kuota e Dhuruar përfaqëson 49% (dyzet e nëntë përqind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- 2.2 Kuota e Dhuruar transferohet dhe kalon në pronësi të Përfituesit në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate të shënuar në faqen e parë të saj.

3. SHPËRBLIMI

- 3.1 Dhurimi i Kuotës së Dhuruar sipas kësaj Kontrate në favor të Përfituesit do të kryhet pa shpërblim.

4. REGJISTRIMI I TRANSFERIMIT DHE PJESËMARRJA NË KAPITAL


- 4.1 Pronësia mbi Kuotën e Dhuruar i kalon Përfituesit në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate të shënuar në faqen e parë të saj dhe Palët duhet të regjistrojnë këtë Kontratë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

5. DEKLARIMET E GARANCITË E DHURUESIT

- 5.1. Dhuruesi deklaron dhe garanton ndaj Përfituesit dhe në favor të tij, se secila nga garancitë dhe deklaratimet ("Garancitë e Dhuruesit") në vijim janë të vërteta dhe të sakta në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- (a) Dhuruesi ka të gjithë të drejtat dhe zotësinë ligjore për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate. Miratimi i bashkëshortit të administratorit dhe ortakut të vetëm të tij është i dhënë nëpërmjet nënshkrimit prej tij të Kontratës;
- (b) Pronësia e Kuotës së Dhuruar:
- i. Dhuruesi është pronari i vetëm ligjor i Kuotës së Dhuruar;
 - ii. Kuota e Dhuruar është nënshkruar dhe emetuar në mënyrën e duhur dhe është paguar plotësisht;
 - iii. Kuota e Dhuruar dhe të gjitha të drejtat e lidhura me to janë të lira nga cdo lloj pengu apo barre të çfarëdo natyre qoftë.

6. DEKLARIMET DHE GARANCITË E PËRFITUESIT

- 6.1. Përfituesi, paraqet dhe garanton ndaj Dhuruesit dhe në favor të tij, se secila nga garancitë dhe deklaratimet në vijim janë të vërteta dhe të sakta në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- (a) Përfituesi ka të gjitha të drejtat dhe zotësinë ligjore për të lidhur këtë Kontratë dhe për të përfunduar transaksionet për të cilat është rënë dakord në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.



7. KOSTOT

- 7.1 Secila Palë duhet të mbajë përsipër kostot e saj lidhur me negociatën, mbylljen dhe nënshkrimin e dokumentave të detyrueshme ligjrisht ose sipas kësaj Kontrate.
- 7.2 Cdo tarifë, taksë ose tatim që duhet paguar nëse ka të tillë si rezultat i nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe i transferimit të Kuotës së Dhuruar, është në ngarkim të Dhuruesit.

8. LIGJI I ZBATUESHEM

- 8.1 Kjo Kontratë dhe marrëdhëniet midis Palëve do të rregullohen nga legjislacioni shqiptar, dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare.

9. JURIDIKSIONI

- 9.1 Cdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë përsa i përket zbatueshmërisë ose vlefshmërisë do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

10. TË NDRYSHME DHE SHTESA


- 10.1 Asnjë ndryshim, shtesë, ose tjetërsim i kësaj Kontrate nuk do të jetë e vlefshme nëse nuk është me shkrim në një dokument të vetëm të nënshkruar nga ose për llogari të Palëve.
- 10.2 Në rast se në çdo kohë ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate është ose bëhet e paligjshme, e pavlefshme ose e pazbatueshme, atëherë kjo dispozitë do të konsiderohet e pavarur nga kjo Kontratë dhe nëse është e mundur do të zëvendësohet nga një dispozitë e vlefshme, e cila do të shprehë, sa më afër të jetë e mundur, qëllimin e Palëve sipas kësaj Kontrate dhe aty ku është e mundur nuk do ndikojë ose dëmtojë vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e ndonjë dispozite tjetër të Kontratës ose të Kontratës në tërësi e cila do të interpretohet dhe do të zbatohet në mënyrë të pavarur.

11. GJUHA, KOPJET E KONTRATËS DHE HYRJA NË FUQI

- 11.1 Kjo Kontratë hartohet në tre kopje në gjuhën shqipe, një për secilën palë dhe një për Shoqërinë ku secila prej tyre do të konsiderohet origjinale, por të gjitha bashkë do të përbëjnë një dhe të njëjtën Kontratë.


Dhuruesi

“Travel Hub Solutions” SHPK
përfaqësuar nga Znj. Nertila Kole


Nertila Kole


Në praninë dhe me miratimin e:

Z. Gentjan Kole


Gentjan Kole

Përfituesi

Znj. Nertila Kole


Nertila Kole